

Znj. Juliana Latifi është zgjedhur Kryetare e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës, me Vendimin nr.96, datë 22.12.2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Znj. Latifi, mban titullin shkencor "Prof.Dr." në fushën e shkencave juridike. Ajo ka marrë gradën shkencore "Dr." në vitin 1997 në të drejtën private, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, si dhe më pas në periudhën 2000-2002 ajo ka realizuar studimet post-doktorale, pranë Fakultetit të Drejtësisë, Shkencave Politike dhe Administrimit, Universiteti Robert Schuman, Strasbourg, Francë në të drejtën private të krahasuar.

Background-i i saj, përfshin një karrierë të gjatë profesionale dhe akademike. Në periudhën 1992-1994 Znj.Latifi ka punuar gjyqtare pranë gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe më pas Gjykatës së Apelit. Në periudhën 1995-2002, Znj.Latifi ka punuar pedagoge e brendëshme në Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë, dhe titullare e lëndëve: E drejta civile; Pronësi, Trashëgimi; dhe E drejta private e krahasuar, ku ka mbajtur edhe funksionin e Shefes së Departamentit të së Drejtës Civile (2000-2002). Në periudhën 2012-2015 ajo ushtruar funksionin e Dekanes në Fakultetin e së Drejtës së Biznesit, Tirana Business University, ku sot ajo vazhdon të jetë pjesë e stafit akademik dhe titullare në lëndët E drejta civile dhe E drejta e konkurrencës.

Znj.Latifi ka nje eksperiencë të pasur në fushën e draftimit të akteve ligjore dhe nënligjore, ku ajo ka punuar si këshilltare ligjore, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, gjatë periudhave 2003-2005 dhe 2013-2016. Ajo ka qenë drejtuese e grupeve të ndryshme të punës, në reformat e rëndësishme legjislativë të realizuara në Shqipëri, në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së.

Në karrierën e saj profesionale, Znj. Latifi është angazhuar si këshillare ligjore edhe pranë organizmave ndërkombëtarë, në Shqipëri dhe jashtë saj, në përgatitjen e studimeve, dhënien e rekomandimeve dhe opinioneve, si dhe draftimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

Background-i i saj, përfshin edhe një kontribut të pasur në fushën e jurisprudencës shqiptare, me publikimin e librave universitarë në fushën e së drejtës civile, të cilat janë pjesë e syllabusit zyrtar në Fakultetet e Drejtësisë në Shqipëri dhe Kosovë, si dhe Shkollën e Magjistraturës, si dhe publikimin e artikujve të ndryshëm shkencorë jashtë vendit.